KOLEGJI UNIVERSUM

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

dhe

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do ti mundësojë studentëve të Kolegjit Universum përfundimin e internshipit/punës praktike me kohëzgjatje të dakorduar në mes të Kolegjit Universum dhe kompanisë së lartpërmendur.

2. Kompania në fjalë duhet të sigurojë punë vullnetare, që ka për qëllim ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit, apo për qëllime tjera beneficiale për të dyja palët. Puna vullnetare sigurohet të gjithë studentëve te Kolegjit Universum, atyre që vijnë nëpërmjet Kolegjit Universum, dhe kandidatëve të projektit TLP (nese fitohet projekti nga Kolegji Universum).

3. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

4. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do të ju mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës të përcaktuar nga institucioni, dhe nuk do të kenë pengesa.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike

1. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike do të bëhet nga Kolegji Universum duke marrë parasysh nevojat dhe konkurset e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

2. Kolegji Universum do të sigurojë që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre profesionale.

V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtinë, më: 10/03/2016

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji ''UNIVERSUM''
Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Arban Abrashi
Ministër